



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA LUSHNJE  
ZYRA E MENAXHIMIT TË ASETETEVE

Nr. 6309 Prot.

Lushnje më, 31/07/2023

RELACION

**“PËR MIRATIMIN E DHËNIES ME QIRA TË PASURIVE NR. 475, ZK. 1033, FSHATI ARDENICË DHE NR. 146/9, ZK. 2207, FSHATI KOLONJË, E LLOJIT PYLL, NJËSIA ADMINISTRATIVE KOLONJË.**

**Të nderuar Zonja dhe Zotërinj Këshilltarë!**

Në inventarin e pronave te paluajtshme shtetërore të miratuara me VKM-në nr. 684, datë 02.09.2020 Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 433, datë 8.6.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe kullotave publike sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-Komunave/Bashkive,” të ndryshuar, pylli figuron me numër rendor 39, kodi kadastral FR13 00 037d, emërtesa e ekonomisë Pyjore dhe Kullosore Gradishtë Gjenerukë, vendodhja fshati Ardenicë, numri i ngastrës nr. 37d, me sipërfaqe 14.51 ha (145.100 m<sup>2</sup>), kategoria e përdorimit të territorit është pyll.

Gjatë regjistrimit fillestar sistematik masiv, të cilin e disponon Drejtoria Vendore e A.Sh.K-së Lushnje, ngastra nr. 37d është ndarë në dy pasuri (sipas statusit juridik):

1. në pasurinë me nr. 475, Vol. 6, Fq. 116, me sipërfaqe 8062 m<sup>2</sup>, e llojit pyll, ZK. 1033, fshati Ardenicë;
2. në pasurinë me nr. 146/9, Vol. 11, Fq. 158, me sipërfaqe 5050 m<sup>2</sup>, e llojit pyll, ZK. 2207, fshati Kolonjë.

Pronat janë regjistruar në DVASHK Lushnje me çertifikatë pronësie nr. 1 datë 14.07.2023 me këto të dhëna: pasuria nr. 475, Vol. 6 Fq. 116, ZK. 1033, fshati Ardenicë, në pronësi të Bashkisë Lushnje, me sipërfaqe 8 300 m<sup>2</sup>, e llojit pyll dhe me çertifikatë pronësie nr. 1602 datë 14.07.2023 me këto të

dhëna: pasuria nr. 146/10 (ardhur nga ndarja e pasurisë nr. 146/9), ZK. 2207, fshati Kolonjë, në pronësi të Bashkisë Lushnje, me sipërfaqe 3 700 m<sup>2</sup>, e llojit pyll.

Mbështetur në ligjin nr 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar, Udhëzim Nr. 1, datë 9.6.2016 “Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullësor publik” dhe Ligjit Nr. 9385, datë 4.5.2005 Për pyjet dhe shërbimin pyjor, i ndryshuar, neni 2, pika 31, 33, ku përcaktohet se e drejta e lidhjes së kontratës së qirasë për pyjet në pronësi të shtetit i takon Ministrisë Përgjegjëse për Pyjet, organit të qeverisjes vendore që ushtron të drejtën e përfaqësuesit të pronarit mbi pronën dhe që në rastin konkret është Këshilli Bashkiak Lushnje.

Për ti vënë në efikasitet të plotë këto prona shtetërore në favor të Bashkisë Lushnje, propozojmë: Miratimin e fillimit të procedurave ligjore për dhënien me qira të pasurive nr. 475, ZK. 1033, fshati Ardenicë dhe nr. 146/10, ZK. 2207, fshati Kolonjë, e llojit pyll, Njësia Administrative Kolonjë për një afat 10 (dhjetë) vjeçar.

Bashkëlidhur:

- VKM-në nr. 684, datë 02.09.2020 Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 433, datë 8.6.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe kullotave publike sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-Komunave/Bashkive,” të ndryshuar dhe fletën e inventarit;
- Plan Rilevimi për këto pasuri.
- Certifikatë pronësie nr. 1 datë 14.07.2023 dhe nr. 1602 datë 14.07.2023;

Faleminderit për mirëkuptimin !

**Konc:** L. Murati

S. Manoku

